

Informatat mbi projektin

Titulli i projektit:	“Fuqizimi i gjeneratës së re të gazetarëve kosovarë”
Vlera e Projektit:	Shuma e përgjithshme € 115,953.70 ; Bashkëfinancimi: € 56,173.28
Kohëzgjatja:	Fillimi: 02/05/2018 Përfundimi: 31/12/2019
Organizata:	Kosovo Glocal (Kosovo 2.0)
Kontaktet e OJQs: Adresa, email, telefonat, uebfaqja	Rr. Rustem Statovci, nr.50-1, 10000, Prishtinë, Kosove Email: kosovotwopointzero@gmail.com ose contact@kosovotwopointzero.eu + 381 38 733 523, + 386 49 149 145, www.kosovotwopointzero.com
Target grupet:	<ul style="list-style-type: none"> – Grupi I: gazetarë të rinj, të punësuar apo të papunë, veçanërisht të moshave 20-25 (me të paktën dy vite përvojë); – Grupi II: gazetarë të rinj, të punësuar apo të papunë 20 deri në 35 vjeç (me të paktën 3 vite përvojë në fushën e gazetarisë); – Grupi III: profesionistë të rinj si krijues të mediave, gazetarë, fotografë, ilustrues, publicistë, montazhierë, regjisorë, bloggerë, dizajnerë grafik, hulumtues dhe publiku i përgjithshëm.
Partnerët (nëse ka):	Për pjesën e bashkëfinancuar nga EUOK: Qendra Kosovare për Studime Gjinore (KGSC) dhe Qendra për Barazi dhe Liri (CEL).
Target Zona:	Projekti do të zbatohet në Prishtinë. Megjithatë, pjesëmarrësit e aktiviteteve të projektit do të vijnë nga qytetet e ndryshme të Kosovës, dhe rezultatet e projektit do të përhapen tek të gjithë qytetarët.
Objektivi i Përgjithshëm:	Përmirësimi i cilësisë së gazetarisë së prodhuar në Kosovë me ndikim substancial dhe afatgjatë dhe ndryshim të praktikave gazetareske për një shoqëri më gjithëpërfshirëse, të barabartë dhe demokratike.
Aktivitetet:	<ul style="list-style-type: none"> – Ligjërata praktike të bazuara në çështje të ndryshme – organizimi i 2 trajnimeve me qëllim të rritjes së njohurive dhe thellimit të kuptueshmërisë së përfituesve mbi standardet profesionale dhe etike në gazetari; – Programi i Mentorimit ‘Përcjellja Profesionale’ – organizimi i dy programave të mentorimit që do të ofrojë ekspertizë në këto fusha tematike: Sektori i Drejtësisë, Marrëveshjet e Brukselit, Tregu i Punës dhe Punësimi, Barazia Gjinore dhe Kultura. Përveç kësaj, pjesëmarrësit do të marrin pjesë në vizita studimore brenda secilës fushë tematike dhe do të punojnë në prodhimin e storieve të detajuara nën mbikëqyrjen e mentorit; – Volume Up – organizimi i 3 edicioneve me folës ndërkombëtarë nga mediat në rajon dhe më gjerë. Secili edicion do të përfshijë një masterclass të mbyllur me gazetarë dhe një bisedë publike; – Bursë e Gazetarisë së të Drejtave të Njeriut: K2.0 ka zhvilluar një bursë të veçantë të gazetarisë për të drejtat e njeriut në mënyrë që të mbështesë gjeneratën e ardhshme të gazetarëve që të kenë njohuri dhe të inkurajohen për të trajtuar më shumë çështje të tilla në domenin publik. Programi do të organizohet 2 herë dhe përfituesit do të prodhojnë një storie hetimore për çështje të lidhura me të drejtat e njeriut.
Rezultatet e Pritura:	<ul style="list-style-type: none"> – Përmirësimi i aftësive profesionale të gazetarëve të rinj duke u përqendruar në qasjen në dokumente dhe informata publike, menaxhimin dhe mbrojtjen e burimeve, përfshirjen dhe diversitetin e perspektivave, forcimin e formateve gazetareske kundrejt opinionit dhe aspekteve të tjera teknike të procesit të prodhimit gazetaresk; – Përmirësimi i kapaciteteve të gazetarëve të rinj duke u përqendruar në njohuritë cilësore dhe të specializuara tematike, përfaqësimi dhe qasja etike në çështjet madhore relevante për shoqërinë kosovare: pajtimi dhe dialogu, qasja në drejtësi, çështjet gjinore, mundësitë e tregut të punës dhe të drejtat e punëtorëve, si dhe rrëfimet kulturore; – Krijimi i kapaciteteve për të mundësuar bashkëpunimin e përgjithshëm në sektorin e medias në Kosovë duke sjellë shembuj ndërkombëtarë dhe rajonalë të disa prej praktikave më të mira në gazetari dhe komunikim; – Të mbështesë dhe të ndërtojë kapacitetet e gazetarëve të rinj profesional me perspektivë të të drejtave të njeriut për të prodhuar storie me cilësi të lartë krijuese, hetimore dhe me ndikim në shoqëri.

Përkrahur nga:



THE GOVERNMENT
OF THE GRAND DUCHY OF LUXEMBOURG